



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), neni 65.2, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 16.09.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. NJOMZA DEMAJ** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Luljeta Zeqiraj.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Njomza Demaj dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 12.09.2019, Nr.1027/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal znj. Luljeta Zeqiraj pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye të detyrës së re në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, e cili është, znj. Njomza Demaj nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 16.09.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdetë Daka